



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

I u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë 30 dhjetor 2020 (e merkur) me fillim në ora 10:00. Mbledhja do të mbahet në lokalet e Hotelit "Amazona".

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 26 nëntor 2020;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 7 dhjetor 2020;
3. Shqyrtimi Draft-Rregullores për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë (**shqyrtimi i dytë**);
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2021;
5. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale – shërbimet sociale, dhe ato të asistencës të Komunës së Vushtrrisë për periudhën janar – nëntor 2020;
6. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave;
7. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2021;
8. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh;
10. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë për Komunikim me publiku në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi dytë**);
11. Shqyrtimi i Draft - Strategjisë Zhvillimore të Komunës për vitet 2020 – 2025 (**shqyrtimi dytë**);
12. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë të përkrahjes së prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi dytë**);
13. Të ndryshme.

Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë rekomandimet e KPF-së dhe materialet për pikat e rendit të ditës.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit